STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 22 tetor 2013

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON RIHAPJEN E NDERMARRJES SE ÇOKOLLATAVE MADELAINE NJE VIT PAS SHKATERRIMIT NGA SUPER STUHIA SENDI (SANDY)

Biznesi 65-vjeçar në pronësi të familjes feston fillimin e ri me rihapjen e madhe dhe punëson 120 punonjës

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se Ndërmarrja e Çokollatave Madelaine, një prodhues në pronësi private i çokollatave me letër sezonale dhe të përditëshme, rihapi zyrtarisht fabrikën e saj 200,000 këmbë katrore në Rokëuejs (Rockaways) pasi pësoi humbje shkatërruese pas super stuhisë Sendi (Sandy) pothuajse një vit më parë. Ndërmarrja vlerëson humbje gjithsej përtej $50 milionë të mjediseve, infrastrukturës dhe pajisjeve të saj të shkaktuara nga vërshimi i stuhisë, duke e detyruar të mbyllë dyert e saj. Madelaine, e cila punësoi më shumë se 315 punonjës me kohë të plotë përpara stuhisë, që atëherë ka shpenzuar më shumë se $10 milionë për pastrim dhe riparime që ishin të nevojshme përpara fillimit të ndonjë prodhimi. Ndërmarrja ka ripunësuar 120 punonjës dhe ka vendosur në përdorim katër nga 14 linjat e saj të prodhimit.

“Shumë biznese vendase si Ndërmarrja e Çokollatave Madelaine pësuan humbje të tmerrshme pas super stuhisë Sendi (Sandy),” tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). “Madelaine, një ndërmarrja mjaft e suksesshme që punësoi qindra banorë të Nju Jorkut (New Yorkers) dhe kishte pothuajse $40 milionë në shitje, u detyrua të mbyllë operacionet e saj në Rokëuejs (Rockaways) pas stuhisë. Por sot, pothuajse një vit më vonë, Madelaine dhe të tjerë janë duke festuar fillime të reja ndërsa vazhdojnë në rrugën drejt rimëkëmbjes. Shteti i Nju Jorkut (New York State) është krenar të ndihmojë Madelaine dhe i përgëzoj për rihapjen e dyerve të tyre për punonjësit dhe klientët. Këmbëngulja e ndërmarrjes gjatë stuhisë tregon atë që mund të arrijmë dhe mund të kapërcejmë kur punojmë së bashku duke ndihmuar komunitetet tona.”

Njoftimi i rihapjes u bë këtë mëngjes nga Jorge Farbër (Jorge Farber), CEO i Ndërmarrjes së Çokollatave Madelaine. Rihapja e madhe mblodhi punonjës dhe një numër klientësh e shitësish të Madelaine, bankierësh dhe zyrtarësh të zgjedhur.

“Jemi të gëzuar që ndajmë këtë moment të veçantë me të gjithë ata që kanë qëndruar pranë Ndërmarrjes së Çokollatave Madelaine që nga fillimi i këtij udhëtimit të vështirë,” tha Farber. “Sot është një trashëgimi e ndihmës së palëkundur që kemi marë nga personeli ynë i përkushtuar dhe nga

komuniteti. Jemi kaq shumë krenarë për ta dhe të ngazëllyer që jemi kthyer."

Madelaine, e cila është punëdhënësja më e madhe në Rokëuejs (Rockaways), është duke vazhduar të rindërtohet dhe është në rrugë drejt rimëkëmbjes. Në pikun e saj, Madelaine ishte duke prodhuar 20 milionë paund të çokollatave të saj çdo vit. Ndërmarrja shpreson të kthehet në kapacitetin e plotë dhe të ripunësojë të gjithë punëtorët e saj brenda 12 mujave të ardhshëm. Në mbështetje të këtij projekti të restaurimit, Empire State Development është duke siguruar $6.9 milionë në kredi ndaj taksave për Ruajtjen e Vendeve të Punës (Jobs Retention) për ruajtjen e 317 vendeve të punës.

"Rihapja e Ndërmarrjes së Çokollatave Madelaine vetëm një vit pasi u shkatërrua nga super stuhia Sendi (Sandy) është një trashëgimi e fuqisë dhe këmbënguljes së kësaj ndërmarrje në pronësi të familjes dhe përkushtimin e saj ndaj rrënjëve në Nju Jork (New York)," tha Presidenti, CEO & Komisioneri i Empire State Development Keneth Edëms (Kenneth Adams). "Që nga momenti që stuhia përfundoi, jemi duke u takuar me bizneset e prekura për të gjetur mënyra sesi mund t'i ndihmojmë që të rimëkëmben dhe me ndihmën tonë Madelaine së shpejti do të kthehet në punësimin e më shumë se 315 punonjësve. Njoftimi i sotëm është një lajm i mire për Rokëuejs (Rockaways), familjen Madelaine dhe punonjësit e tyre dhe milionat e njerëzve përreth globit që shijojnë produktet e tyre të mrekullueshme."

Projekti i rimëkëmbjes së Madelaine gjithashtu është caktuar si një projekt përparësie më 2013 nga Këshilli Rajonal i Zhvillimit Ekonomik të Qytetit të Nju Jorkut (New York City) dhe përputhet me Planin Strategjik duke mbështetur bizneset e vogla dhe duke mbështetur industritë strategjike si prodhimi.

Anëtari i Kongresit Gregëri W. Miks (Gregory W. Meeks) tha, "Ndërsa Rokëuejs (Rockaway) rindërtohet është kritike që bizneset e vogla të rifillojnë funksionimin, të krijojnë vende pune dhe të rikthejnë qëndrueshmërinë e komunitetit. Jam i gëzuar të kem ndihmuar një nga punëmarrëset më të mëdha të Rokëuejs (Rockaways), Ndërmarrjen e Çokollatave Madelaine në përpjekjet e saj për të patur një hua të Administrimit të Biznesit të Vogël (SBA) së bashku me stimuj të tjerë financiarë. Përgëzoj Guvernatorin Kuomo (Cuomo) për dhënien ndaj Çokollatave Madelaine të $6.7 milionë në kredi të taksave dhe për mbështetjen e vazhdueshme për t'u siguruar se Shteti i Nju Jorkut (New York State) është një partner aktiv në rindërtimin e Rokëuejs (Rockaways)."

Senatori Xhozef P. Adabo Jr. (Joseph P. Addabbo, Jr.) tha, "Bashkohem me votuesit e mi të Rokëuejs (Rockaway) në gëzimin se shohim që uzina e Çokollatave Madelaine prodhon mijëra paund të çokollatave me letër përsëri, në kohë për sezonin e festave të Hellouin, Ditës së Falënderimit dhe Krishtëlindjeve. Koha e rihapjes dhe ripunësimi i pothuajse gjysmës së forcës fillestare të punës të saj deri në tetor ishte vendimtare për Madelaine dhe komunitetin. Falë dhurimit të Bllokut Kombëtar, mbështetjes së zyrtarëve të zgjedhur, zyrës së guvernatorit dhe fondeve të Empire State Development, punëdhënësja me e madhe e Rokëuejs (Rockaway) mënë fund është kthyer duke prodhuar disa nga çokollatat më të mira në botë."

Anëtari i Asamblesë Fil Golldfedër (Phil Goldfeder) tha, "Ndërmarrja e Çokollatave Madelaine nuk është vetëm një gur i çmuar i komunitetit, por ka qënë një nga punëdhënëset dhe mbështetëset më të mëdha

të komunitetit tonë për disa dekada. Si duzina biznese të tjera të familjeve, Ndërmarrja e Çokollatave Madelaine u përpoq të rimëkëmbej nga shkatërrimi i shkaktuar nga Sendi (Sandy). Dëshiroj të falënderoj Guvernatorin Kuomo (Cuomo) dhe Anëtarin e Kongresit Miks (Meeks) që ndihmuan Çokollatat Madelaine në rrugën e tyre drejt rimëkëmbjes. Kjo rihapje dërgon një mesazh të forte për komunitetin se do të vazhdojmë të rindërtojmë dhe do të kthehemi më të fortë dhe më këmbëngulës se kurrë."

Rreth Ndërmarrjes së Çokollatave Madelaine

E themeluar më 1949 nga të mbijetuarit e Holokaustit dhe kunetërit Henri Kei (Henry Kaye) dhe Xhek Golld (Jack Gold), Ndërmarrja e Çokollatave Madelaine është një biznes i brezit të tretë në pronësi dhe në funksionim nga familja. E vendosur në Rokëuej Biç (Rockaway Beach), Madelaine ka qënë pjesë e jetës—dhe traditës—Amerikane për pothuajse 65 vjet. Çokokallata Madelaine mund të gjendet anembanë botës me produktin tani të disponueshëm në Lindjen e Mesme, Europë dhe Azi.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418